

Letërnjoftimi i Komunës së

DEÇANIT

2014

Maj, 2015



Fakte


- Të hyrat buxhetore të komunës së Deçanit më 2014 kanë shënuar një rritje lehtë në krahasim me një vit më parë.
- Në administratë komunale janë të punësuar 145 persona, apo një shërbyes civil për 279 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 584 persona, prej tyre 473 mësimdhënës. Në Komunën e Deçanit raporti nxënës/mësimdhënës është 15,1. Mesatarja në shkallë vendi është 29,9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 127 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Deçanit është 319,3. Ky numër është i lartë duke e krahasuar me mesataren në shkallë vendi e cila është 282,7.
- Deçani gjatë vitit 2014 ka pasur 2,689 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Deçan rreth 7% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Deçanit funksionojnë 1,966 biznese.
- Prej bizneseve ekzistuese, në Deçan janë 1,847 biznese individuale/familjare.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 94 biznese të reja, shumica janë biznese tregëtare dhe biznese të ndërtimit.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 9 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Deçanit gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 22 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 27%. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

2 Qeverisja komunale

Edhe pas zgjedhjeve të fundit lokale (2013), Komuna e Deçanit ka vazhduar të qeveriset nga Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK). Kryetari aktual i Deçanit z.Rasim Selmanaj ka fituar mandatin në raundin e parë të zgjedhjeve komunale me 8,669 apo 54,26%, Ky është mandati i tij i dytë si kryetar i Komunës së Deçanit.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 16,195 apo rreth 40,6% qytetarë me të drejtë vote.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: AAK-LDD 13 ulëse, LDK 9 ulëse, PDK katër ulëse, VV me dy ulëse.

Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Deçanit në bazë të zgjedhjeve 2013




Ekzekutivi komunal i Deçanit ka 11 drejtori komunale. Pas zgjedhjeve, Kryetari z.Rasim Selmanaj ka arritur marrëveshje me LDD para zgjedhjeve për bashkëqeverisjen e komunës.

3 Buxheti i Komunës së Deçanit


Më 2014, Komuna e Deçanit kishte buxhet prej 7,1 milion eurove, një rritje prej afro 500 mijë eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje apo 4,6 milion euro të buxhetit, ku 3,1 milion euro shpenzohen për punëtorët e arsimit, 800 mijë euro për ata të shëndetësisë dhe afër 130 mijë euro për administratë. Buxheti për investime kapitale është 1,5 milion euro, një rënie e lehtë në krahasim me dy vitet paraqake.

Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Deçanit dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Deçanit kanë qenë afro 434 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2013.

Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Deçanit 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 43% të të hyrave të përgjithshme.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Deçanit ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Skenderaj, Malisheva, Kaçaniku, Shtime, etj., ndërsa më pak se sa Vitia, Klina, Kamenica, Istogu etj.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë




Sa i përket shpenzimeve për telefona mobil, telefona fikse, riparimi i veturave, kanë shënuar rritje të dukshme në krahasim me një vit më parë, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.

Grafikoni nr. 7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Komuna e Deçanit gjatë vitit 2014 ka shpenzuar për energji elektrike rreth 140 mijë euro, apo 18 mijë euro me shumë krahasuar me një vit më herët.


Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Deçan e ka përmbyllur me 1,166 të punësuar në sektorin publik, gjashtë më shumë se sa një vit më parë. Përgjatë këtij viti, janë punësuar tre shërbyes civil më shumë në kuadër të administratës dhe tre punonjës në sektorin e arsimit.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Deçanit




Krahasuar me komunat tjera Deçani qëndron mirë me numrin e shërbyesve civil, punëtorët shëndetësor edhe arsim. Numri i punësuarve në administratë është 145 persona, që është 279 për kokë banori, ndersa ne nivel vendi është 278 për kokë banori.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 584 persona, prej tyre 473 mësimdhënës. Në Komunën e Deçanit raporti nxënës/mësimdhënës është 15,1. Mesatarja në shkallë vendi është 29,9. Në sektorin e arsimit Deçani ka të punësuar më shumë staf se sa mesatarja në shkallë vendi.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Deçanit



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 127 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Deçanit është 319,3. Mesatarja në shkallë vendi është 282,7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale


Në Komunën e Deçanit ne vitin 2014 janë regjistruar 94 biznese të reja. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë në fushë veprimtari tregtare dhe biznese të ndërtimit. Në vitin 2014 shihet një numër më i vogël i bizneseve të reja të regjistruar krahasuar në tredin e dy viteve të fundit.

Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 9 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë dhe biznese tjera të vogla. Duke i krahasuar trendin e 4 viteve paraprake numri i bizneseve të shuara është më i vogël.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014



6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z.Rasim Selmanaj gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 22 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z.Selmanaj ka arritur të realizoj 27% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org